



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 66, datë 24.05.2021

**PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TOTAL PREJ 3'074'534 LEKË PËR
ZBATIMIN E PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I KËNDIT TË LOJRAVE DHE KRIJIM
HAPËSIRE REKREATIVE TEK KOPSHTI "NEIM BABAMETO", DURRËS" SI NJË
KONTRIBUT I PËRBASHKËT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE SHOQATËS
"WORLD VISION"**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023" si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe Drejtorisë së Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e përdorimit të fondit total prej 3'074'534 lekë për zbatimin e projektit "Rikualifikimi i këndit të lojërave dhe krijim hapësire rekreative tek kopshti "Neim Babameto" si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe Shoqatës "World Vision".

2. Ky fond do të mbulohet si kontribut i përbashkët në vlerën 2'374'534 nga Shoqata “World Vision” dhe në vlerën 700'000 lekë nga ana e Bashkisë Durrës, fond i cili do të merret nga fondi i kontigjencës i miratuar me VKB-në nr. 123 datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 dhe projektbuxhetin afatmesem të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023 ”.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare si dhe Njësia e Prokurimit, Bashkia Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 24.05.2021

Rruga Aleksander Goga

Rruga Rexhep Mezini

Territori i shkolles



BASHKIA DURRES
Dt. 28.05.21 Nr. 6010/20 PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 369/prot.
/1.

Durrës, më 27.05.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 66 datë 24.05.2021 Për miratimin e përdorimit të fondit total prej 3'074'534 lekë për zbatimin e projektit "Rikualifikimi i këndit të lojrave dhe krijim hapësire rekreative tek kopshti "Neim Babameto", Durrës" si një kontribut i përbashkët midis Bashkisë Durrës dhe shoqatës "World Vision".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

